

KERKESE

KERKUES: Gjika Stramarko

OBEKTI: Marrja e masave për shmangien e nderhyrjes në ekzekutim të vendimit nr. 188, datë 10.09.2021 “Për prishjen e objektit të kunderligjshëm”.

DREJTUAR: Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Tiranë
Kryeinspektorit z. Agim Ismaili

Për Dijeni: Struktura së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Kontrollit të Lartë të Shtetit

Kemi ardhur në dijëni se prej IKMT po planifikohet nderhyrja për prishjen e objektit të kunderligjshëm, të ndodhur në fshatin Dhermi, Bashkia Himarë, në ekzekutim të vendimit nr. 188, datë 10.09.2021 “Për prishjen e objektit të kunderligjshëm”. Si date ekzekutimi është përcaktuar 04.11.2023, ora 08:30.

Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë po shqyrtohet çështja administrative me palë paditese shoqëria Gjika Stramarko, Shoqëria “Dhermiu 001” sh.p.k., Kristaq Beli, palë të paditur IKMT dhe objekt “Kundershtim i veprimeve të IKMT Tiranë, konstatim i paligjshmerisë së tyre dhe detyrimi i palës së paditur të ndalojë kryerjen e veprimeve që cenojnë integritetin e objektit të ndërtuar nga pala paditese.

Kundershtim i proces verbalit nr. 02, datë 07.09.2021 të IKMT Tiranë. Shprehim i demit të shkaktuar në objektin e paditesave nga veprimet e palës së paditur, etj.”.

Me njoftimin e vendimit nr. nr. 188, datë 10.09.2021 “Për prishjen e objektit të kunderligjshëm” të IKMT-së, është shtuar objekti i padisë dhe pjesë e kerkimeve të saj është bërë edhe kundershtimi i këtij vendimi.

Me momentin e parë që IKMT ka tentuar të prishte objektin, me vendimin nr. 210, datë 14.09.2021 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesës së palës kerkuese shoqëria “Dhermiu-001” sh.p.k. dhe Kristaq Beli për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

2. Përzullimin e veprimeve të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Tiranë për prishjen e objektit të ndërtuar sipas projektit të lejes së ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të Këshillit të Rregullimit të Territorit, Bashkia Himarë dhe

vendimit nr. 21, date 13.12.2019 te Kryetarit te Bashkise Himare per zgjatjen e afatit te zbatimit te punimeve, deri ne zgjidhjen ne temel te kerkesepadise.

3.Kerkuesi detyrohet te depozitoje kerkesepadine ne gjykate brenda 10 diteve nga shpallja e ketij vendimi, ne te kundert masa e sigurimit te padise konsiderohet e rene....

Me vendimin nr. 42, date 27.04.2023 Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur:
1.Ndryshimin e vendimit nr. 210, date 14.09.2021 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore dhe rrezimin e kerkeses per sigurimin e padise, qe i perket kerkuesave shoqeria "Dhermiu-001" sh.p.k. dhe Kristaq Beli.

Me zbardhjen e ketij vendimi dhe renien e mases eshte tentuar prape prej IKMT-se prishja e objektit tone ne Maj te vitit 2023, bazuar pikerisht ne faktin e renies se mases per sigurimin e padise. Kjo nderhyrje nuk ka vazhduar.

Pas ushtrimit te rekursit nga ana jone, me vendimin nr. 00-2023-3141 (276), date 27.07.2023 te Kolegjit Administrativ te Gjykates se Larte eshte vendosur prishja e vendimit nr. 42, date 27.04.2023 te Gjykates Administrative te Apelit dhe lenia ne fuqi e vendimit nr. 210, date 14.09.2021 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore.

Pra, aktualisht jemi ne kushtet kur masa e sigurimit te padise, e vendosur me vendimin nr. 210, date 14.09.2021 te Gjykates Administrative e Shkalles se Pare Vlore, vazhdon te jape efektet e veta, duke mos lejuar kryerjen e asnje veprimi te IKMT-se per prishjen e objektit tone.

Ne kushtet e mesiperme, kerkojme qe ne respektim te vendimmarrjes gjyqesore, deri ne Gjykatën e Larte, te shmanget nga ana juaj kryerja e çdo veprimi per prishjen e objektit, tone, pasi çdo veprim i tille do te ishte i kunderligjshem, ne kundërshtim me nje vendim gjyqesor te formes se prere dhe i penalizueshem per disa vepra penale.

Bashkelidhur po paraqesim kopje te vendimit nr. 00-2023-3141 (276), date 27.07.2023 te Kolegjit Administrativ te Gjykates se Larte, i cili normalisht i eshte njoftuar edhe institucionit tuaj.

KERKUES

Gjika Stramarko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV



Nr. 35005-00276-00-2023 i Regjistrimit Themeltar
Nr. 00-2023-3141 i Vendimit (276)

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Enkelejda METALIAJ(SOFTA) - Kryesuese
Arbena AHMETI - Anëtare
Asim VOKSHI - Anëtar

sot më datë 27.07.2023, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative nr. 35005-00276-00-2023, që u përket palëve:

KËRKUES:

Shoqëria "Dhërmiu-001" shpk.

Kristaq Beli.

PALË E TRETË:

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit Tiranë

Me thirrjen e Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Vlorë.

OBJEKTI:

Marrja e masës së sigurimit të padisë, pezullimi i gjithë veprimeve të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Tiranë për prishjen e objektit të palës kërkuese, të ndërtuar sipas lejes së ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të Këshillit të Rregullimit të Territorit, Bashkia Himarë dhe zgjatjes së afatit të saj me vendimin nr. 121, datë 13.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë Himarë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 32, 154, të Kodit të Procedurës Civile, ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit". Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Enkelejda Metaliaj (Softa) dhe si bisedoi çështjen në tërësi në dhomë këshillimi,



VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Bashkia Himarë, në bazë të vendimit nr. 62, datë 16.12.2010 të Këshillit të Rregullimit të Territorit (në vijim KRRT) ka miratuar lejen për ndërtimin e objektit “Bar-Restorant-Hotel 3 kate në Dhërmi” për shtetasit të z. Kristaq Beli dhe z. Foto Stramarko, sipas parametrave të miratuar me vendimin nr. 15, datë 18.11.2009 “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij” të KRRT Bashkia Himarë.

2. Me qenë se punimet ndërtimore për objektin e mësipërm nuk janë përfunduar brenda afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit, nr. 62, datë 16.12.2010 të KRRT Bashkia Himarë, kërkuesit në bazë të kërkesës nr. AN26092019003, datë 26.09.2019 i kanë kërkuar Kryetarit të Bashkisë Himarë shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit.

3. Me vendimin nr. 121, datë 13.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë Himarë është shtyrë afati i përfundimit të punimeve për lejen e ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të KRRT Bashkia Himarë deri në datën 13.12.2021.

4. Rezulton se në cilësinë e ndërtuesit të këtij objekti është shoqëria “Dhërmiu – 001” shpk. person juridik, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS L17001201F, me seli në fshatin Dhërmi, me objekt të aktivitetit prodhim materiale inerte - gurë, ndërtime civile deri në 5 kate, etj. Ndërkohë, kërkuesi Kristaq Beli rezulton të jetë me cilësinë e pronarit dhe zhvilluesit të këtij objekti.

5. Ndërtimi i objektit i është nënshtruar kontrollit të inspektorëve të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (në vijim IKMT) më datë 07.03.2021. Gjendja e konstatuar është pasqyruar në procesverbalin nr. 02, datë 07.03.2021, seria nr. 0001832 “Për konstatimin e kundërvajtjes”, në të cilin është pasqyruar fakti se: “Kundërvajtja shtesë kati nëntokë, shtesë anësore kati 3-të, shtesë kati 4-të dhe shtesë kati 5-të pa leje ndërtimi ... u konstatua objekt 5-kate në një kat nëntokë me konstrukcion B/A dhe muraturë tulle. Objekti është i pajisur me leje ndërtimi me vendimi KRRT nr. 62, datë 16.12.2010 dhe miratimin e shtyrjes së lejes nr. 121, datë 13.12.2019 për bar-restorant-hotel 3 kate. Nga verifikimi në vend u konstatua shtesë kati nëntokë me sipërfaqe (afërsisht) 710 m², shtesë anësore kati 3-të me sipërfaqe (afërsisht) 165 m², shtesë kati 4-të me sipërfaqe (afërsisht) 700 m² dhe shtesë kati 5-të me sipërfaqe (afërsisht) 445 m², pa leje ndërtimi. Objekti është ndërtuar në zonë me përparësi turizmi”. Në rubrikën e procesverbalit “Subjekti i kontrolluar” është bërë shënimi nga ana e inspektorëve “Dhërmiu - 001”. Jo prezent, u nis me postë”.

6. Personi i tretë IKMT Tiranë me shkresën nr. 3545/1 Prot, datë 08.09.2021 i ka njoftuar kërkuesve, nëpërmjet shërbimit postar, procesverbalin e konstatimit nr. 02 (seria 0001832), datë 07.09.2021, pasi kërkuesit nuk kanë qenë prezent në momentin e ushtrimit të kontrollit.

7. Kërkuesit pretendojnë së inspektorë të IKMT janë paraqitur më datë 09.09.2021 në objekt, pa asnjë vendim mbi prishjen e objektit, për të kryer matjet e nevojshme për vendosjen e lëndës plasëse për prishjen e objektit. Në këto kushte, kërkuesit duke pretenduar se janë në kushtet e nenit 29 të ligjit nr. 49/2012 i janë drejtuar me datë 09.09.2021, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesën për sigurimin e padisë.

8. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 210, datë 14.09.2021 ka vendosur:

“Pranimin e kërkesës së palës kërkuese shoqëria “Dhërmiu-001” shpk. dhe Kristaq Beli për marrjen masës së sigurimit të padisë. Pezullimin e veprimeve të Inspektoratit Kombëtar të

Mbrojtjes së Territorit Tiranë për prishjen e objektit të ndërtuar sipas projektit të lejes së ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të Këshillit të Rregullimit të Territorit, Bashkia Himarë, dhe vendimit nr. 121, datë 13.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për zgjatjen e afatit të zbatimit të punimeve, deri në zgjidhjen në themel të kërkesëpadisë. Kërkuesi detyrohet të depozitojë kërkesë padinë në gjykatë brenda 10 ditëve nga shpallja e këtij vendimi, në të kundërt masa e sigurimit të padisë konsiderohet e rënë. ...”

9. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vlerësuar se nisur nga vlerësimi i rrethanave specifike të rastit objekt gjykimi në raport me kushtet ligjore për sigurimin e padisë, të përcaktuara në nenet 28 dhe 29 të ligjit nr. 49/2012, konkludon se ato u plotësuan nga ana e paditësit në rastin objekt gjykimi. Gjykata vlerëson se kërkuetit provuan me anë të provave shkresore të lejes së ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të KRRT, Bashkia Himarë, si dhe vendimit nr. 121, datë 13.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për zgjatjen e afatit të zbatimit të punimeve, se janë titullar të drejtave të ligjshme mbi objektin ndërtimor që përfshihet në projektin që shoqëron lejet ndërtimore. Rezulton se kërkueti kërkon që në padinë që do të paraqesë në të ardhmen, të mbrojë të drejtat subjektive të pronësisë nga veprimet e punonjësve të IKMT Tiranë për prishjen e objektit. Ndërsa, sa i përket objekteve informale të cilat janë objekt deklarimi të “Kërkesës për legalizim të ndërtimit pa leje” nr. 9342, datë 20.05.2021 dhe të “Kërkesës për legalizim të ndërtimit pa leje” nr. 19222, datë 09.09.2021 nuk konstatohet nëse ato janë lidhura si shtesë me objektin e ligjshëm të sipërcituar, sepse në këto deklarime nuk është bërë shënimi “Objekt me shkelje të lejes së ndërtimit”. Gjykata vlerëson se në rastet kur paraqitet kërkesa për sigurimin e padisë përpara ngritjes së padisë, pala kërkuete ka detyrimin ligjor që të provojë para gjykatës; së pari se cila është padia që ajo do të paraqesë në të ardhmen, pasi, në këtë aspekt, minimalisht identifikohen qartë palët në konflikt dhe objekti padisë që ajo do të paraqesë në të ardhmen dhe, së dyti rrethanat të cilat e pengojnë atë që ta paraqesë padinë njëkohësisht së bashku me kërkesën. Në rastin konkret, në kushtet kur palës kërkuete i është komunikuar nga IKMT Tiranë shkresa nr. 3545/1 prot., datë 08.09.2021 (njoftimi i procesverbalit të konstatimit) pas datës 11.09.2021, si dhe duke qenë se referuar nenit 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 brenda 10 ditëve nga marrja e kopjes së procesverbalit ose e njoftimit për rezultatin e kontrollit IKMT nxjerr vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, ndërkohë që njëkohësisht punonjësit e IKMT po kryejnë veprime në funksion të prishjes së objektit pa u njoftuar kërkuetesve ndonjë vendim përfundimtar të IKMT-së për prishjen e objektit, pala kërkuete ka provuar para gjykatës se eventualisht se IKMT Tiranë mund të ketë marrë ndonjë vendim për prishjen e objektit pas datës 11.09.2021, por nuk është në dijeni të këtij vendimi. Kësisoj, pala kërkuete ka provuar se cila do të jetë padia që do të parashtrijë në të ardhmen para gjykatës, duke identifikuar qartë palët në konflikt dhe objektin e padisë si dhe ka provuar gjithashtu edhe pamundësinë e ngritjes së padisë së bashku me kërkesën pasi ai nuk është njohur akoma me vendimin përfundimtar të IKMT-së për ta identifikuar atë akt administrativ qartësisht para gjykatës me anë të kërkesëpadi. Lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshem dhe të atëçastshëm për paditësin. Referuar deklarimeve të kërkuetesve, fotove të depozituar nga ana e tij, procesverbalit të konstatimit nr. 02 (seria 0001832), datë 07.03.2021 nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, mungesa e informimit zyrtar të kërkuetesve nga ana e IKMT-së, jo vetëm për vendimin administrativ të prishjes së objektit, por edhe për masën objektit që do të mund të prishet, duke informuar se nëse objekti i ligjshëm përfshihet apo jo në veprimet e prishjes, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29, shkronja “a” të ligjit nr. 49/2012 kryerja e veprimeve të punonjësve të IKMT-së për shkatërrimin me eksploziv apo edhe mjete të tjera të objektit të ligjshëm me leje

ndërtimit do të çonte në dëm të rëndë, të atë çastshëm dhe të riparueshëm për palën kërkuese, pasi dyshohet objektivisht se ekziston rreziku që objekti i tyre për të cilin është dhënë leja e ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të KRRT, Bashkia Himarë, mund të priset dhe nuk do të ekzistojë në kohën që gjykata do të mund të shprehet mbi themelin e mosmarrëveshjes dhe ligjshmërinë e veprimeve të IKMT-së. Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se në zbatim të nenit 30 shkronja "b" ligjit nr. 49/2012 duhet marrë masa për të pezulluar veprimet e mëtejshme punonjësve të IKMT Tiranë për prishjen e objektin për të cilin është dhënë leja e ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të Këshillit të Rregullimit të Territorit Bashkia Himarë, sipas projektit që shoqëron këtë vendim. Lidhur me mos cenimin rëndë të interesit publik. Në rastin konkret, objekti ndërtimor për të cilin është dhënë leja e ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të Këshillit të Rregullimit të Territorit Bashkia Himarë dhe për të cilin por kryhen veprime për prishje, vërtetë është ndërtuar në zonë me përparësi turizmi, por kushtet urbanistike si zonë e tillë janë marrë në konsideratë dhe vlerësuar nga organet që kanë dhënë lejen e ndërtimit, në këtë kuptim nuk kemi cenim të rëndë të interesit publik. Gjithashtu, nuk rezulton që në këtë territor të jetë ndonjë projekt investim strategjik nga shteti që ka impakt për publikun. Përkundrazi, gjykata e vlerëson të drejtë dhe pretendimin e palës kërkuese se në rast se palës kërkuese i priset pa të drejtë objekti i realizuar sipas lejes së ndërtimit dhe mbi të cilin gëzon të drejta të ligjshme dhe shteti do të duhej të dëmshpërblejë këto të drejta, duke përdorur mjete monetare nga buxheti i shtetit, cenohet interesi publik, pasi këto vlera monetare mund të përdoren nga shteti jo për shpërblimin e kërkueseve, por për ndërtimin e ndonjë vepre publike."

10. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim të veçantë personi i tretë Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 210, datë 14.09.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e kërkesës, duke pretenduar ndër të tjera se:

- Nga inspektimi i kryer si dhe korrespondenca me institucionet përkatëse, janë evidentuar shkeljet ligjore të cilat kanë lidhje me objektin e ndërtimit të subjektit ndërtues shoqëria "Dhërmiu-001" shpk. dhe Kristaq Beli, ndërtim i cili ndodhet në zonën e Dhërmiut e cila kategorizohet si zonë me rëndësi kombëtare.
- Nga ana e IKMT-së është mbajtur procesverbali i Konstatimit të Kundërvajtjes nr. 02, datë 27.09.2021 me nr. 0001832 serie, i cili në thelb të saj është një "Akt Konstatimi" në një procedurë inspektuese dhe për më tepër nuk sjell dhe nuk ka asnjë pasojë juridike të dhënë. Ashtu siç përshkruhet edhe në akt konstatimin e mbajtur, janë evidentuar shkeljet: "Shtesë kati nëntokë, shtesa anësore kati 3-të, shtesë kati 4-të dhe shtesë kati 5-të, pa leje ndërtimi".
- Kemi të bëjmë me një objekt 5 kate i pajisur me leje ndërtimi me vendimin e KRRT nr. 62, datë 16.12.2010 në zonë me rëndësi kombëtare, dhe ndërtimet e konstatuara në shkelje të plotë ligjore janë jashtë përcaktimit dhe kritereve të kësaj leje të dhënë. Është absolutisht e papranueshme dhënia e masës së sigurimit të padisë ndaj një akt konstatimi.
- Referuar nenit 28 të ligjit nr. 49/2012, gjykata duhet të vlerësonte se nuk jemi në kushtet e një ekzistence të një dëmi të rëndë apo të pa riparueshëm për sa kohë procesverbali i IKMT-së është vetëm një akt konstatimi dhe pa pasojë juridike.
- Referuar nenit 29 të ligjit nr. 49/2012, gjykata përveç se duhet të kishte njoftuar organin administrativ dhe të kishte administruar provat shkresore, duhej të merrte në konsideratë faktin se kemi të bëjmë me objektin në ndërtim në zonë me rëndësi kombëtare dhe si e tillë cenohet rëndë interesi publik.

- E konsiderojmë të papranueshëm rastin konkret kur gjykata arrin në përfundime të cilat tregojnë njëanshmëri në një proces gjyqësor apo dhe ndodhet para një zbatimi të gabuar të procedurës gjyqësore ose në kundërshtim të plotë të legjislacionit të brendshëm dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ).

11. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim të veçantë Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 210, datë 14.09.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e kërkesës, duke pretenduar ndër të tjera se:

- Avokatura e Shtetit, e cila është vënë në dijeni për vendimin nr. 210, datë 14.09.2020, më datë 15.09.2021, nr. 1386 prot., të arkivës së Zyrës Vendore të Avokatit të Shtetit Vlorë, nuk ka qenë e thirrur në seancën në dhomë këshillimi ku është thirrur personi i tretë IKMT Tiranë, duke mos pasur në dispozicion aktet provuese për këtë kërkesë.
- Vendimi është dhënë në kundërshtim me nenet 17 dhe 37 të ligjit nr. 49/2012.
- Kërkimi për marrjen e masës së sigurimit mbi bazë të pohimit të kërkuarit pa akt është i pabazuar dhe si e tillë në respektim të nenit 25 të ligjit nr. 49/2012 duhet të ishte mospranimi i saj, kthimi me të meta.
- Vendim është dhënë në kundërshtim me nenin 28/3 të ligjit nr. 49/2012.
- Në kushtet kur gjykata ka marrë një masë sigurimi në prezencë të kërkuarit pa njoftuar IKMT dhe Avokaturën e Shtetit e bën vendimin të cenueshëm ligjërisht pasi referuar vendimit konstatohet se kërkesa me nr. 210 regj., datë 09.09.2021 është regjistruar në gjykatë dhe vendimi është marrë në datë 14.09.2021. Në rastin objekt gjykimi nuk jemi përpara rasteve të parashikuara në nenet 28, 29 të ligjit nr. 49/2012, as edhe të nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile, pasi vetëm prezenca e kërkuarit dhe mosnjoftimi i palëve të tjera në proces në respektim të konstatimit e bën vendimin të cenueshëm kjo edhe në respektim të nenit 7 të Kodit të Procedurës Civile.
- Vendimi është i pabazuar edhe për faktin se është dhënë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 49/2012.
- Njoftimi i akteve Avokaturës së Shtetit është i detyrueshëm pasi Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin në rastet e parashikuara me ligj. Gjykata, që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim.
- Në këto kushte në mbështetje të analizës së mësipërme vendimi i dhënë prej gjykatës është dhënë në shkelje të rënda procedurale.
- Ky qëndrim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, bie në kundërshtim të hapur me vendimin nr. 13, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për unifikim të praktikës gjyqësore.
- Rrethanat dhe fakti juridik në rastin konkret nuk e përlligjin vendosjen e masës së sigurimit pasi nuk plotësohet asnjë nga rastet që parashikohet në rastin objekt gjykimi.
- Nga pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura deri në këtë moment nga kërkuari nuk provohet ekzistenca e kushteve të parashikuara në nenin 29 të ligjit nr. 49/2012, për marrjen e një mase sigurimi padie.
- Kërkimi është tërësisht i pabazuar në prova dhe në ligj.
- Nga ana e palës kërkuare nuk është provuar se do t'i vijë një dëm i rëndë, i atëçastshëm e mbi të gjitha i riparueshëm.
- Pala kërkuare nuk legjitimohet në kërkimin e saj pasi rezulton, nga deklaratimet e saj, referuar 2 kërkesave për legalizim, njëra më datë 09.09.2021, proces-verbalit të

konstatimit nr. 02, datë 07.03.2021, se kërkuesi ka shkelur lejen e ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të Këshillit të Territorit.

- Gjithashtu, që gjykata bazuar në nenin 29 të ligji nr. 49/2012 të vendosë sigurimin e padisë, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme: a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshem dhe të atëçastshëm për paditësin; b) nuk cenohet rëndë interesi publik.
- Sa i përket premisë së dytë, parashikuar në nenin 29, në analizimin e situatës dhe në dhënien e së drejtës, do të duhet të prevalojë interesi publik dhe konstatimi i bërë nga ana e inspektorëve tregon qartazi që ky interes dëmtohet. Vetë fakti që ky ndërtim i nisur në vitin 2010, ende i papërfunduar, në zonë me interes të lartë për turizmin, në shkelje të lejes, është në shkelje të hapur me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e ndërtimit, pezullimi i zbatimit të këtyre akteve do të sillte pikërisht cenimin e interesit publik. Si rrjedhojë nuk plotësohet elementi i dytë i përcaktuar në dispozitat e ligjit në fjalë, si një kusht i domosdoshëm për pranimin e kërkesës për sigurim padie.

12. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 42, datë 27.04.2023 ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr. 210, datë 14.09.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë, që i përket kërkueseve shoqëria “Dhërmiu -001” shpk. dhe Kristaq Beli. ...”

13. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se pretendimi i të dy ankesave, personit të tretë IKMT dhe Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, për shkelje të procesit të rregullt ligjor se kërkesa është shqyrtuar pa u thirrur ata në gjykim është e pabazuar në ligj pasi referuar përcaktimit ligjor në nenin 28 pika 3 të ligjit nr. 49/2012, kërkesa për sigurimin e padisë në raste të ngutshme mund të gjykohet në dhomë këshillimi pa u thirrur palët. Po ashtu, rezulton se ky vendim iu është njoftuar ankuesve referuar dëftësive të komunikimit dhe ata kanë ushtruar brenda afatit ligjor të drejtën e ankimit në apel kundër tij. Përsa i takon shkaqeve të ankimit të paraqitura nga personi i tretë IKMT dhe atij të paraqitur nga Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se shkaqet e ngritura janë të mbështetura në ligj dhe në prova. Për rrjedhojë, vendimi nr. 210, datë 14.09.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë duhet të ndryshohet dhe të rrëzohet kërkesa e palës kërkuese shoqëria “Dhërmiu-001” shpk. dhe Kristaq Beli, për marrjen masës së sigurimit të padisë. Kjo gjykatë thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshem dhe të atëçastshëm për paditësin dhe mungesa e cenimit të rëndë të interesit publik janë kushte kumulative, të cilat përlligjin nevojën për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Dhënia e garancisë nuk është kusht i domosdoshëm në caktimin e masës së sigurimit të padisë, por një kusht alternativ, i nevojshëm vetëm nëse do të vlerësohej nga gjykata si i përshtatshëm për rrethanat e rastit, për tu zbatuar kurdoherë së bashku me dy kriteret e parashikuara në shkronjën “a” dhe “b”. Kjo gjykatë vlerëson se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, nuk ka interpretuar drejtë dispozitat e ligjit procedural, në lidhje kushtet dhe kriteret për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Konstatohet se gjykata nuk ka analizuar dhe argumentuar në mënyrë të drejtë kriteret e domosdoshme për marrjen e masës së sigurimit të padisë, ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshem dhe të atëçastshëm për paditësin. Dëmi që pretendon kërkuesi nuk është i atëçastshëm dhe nuk është i asaj natyre që të rrezikojë të drejtën që kërkon të mbrohet dhe të pamundësojë apo vështirësojë ekzekutimin e vendimit në eventualitetin e pranimit të padisë. Dëmi i pretenduar nga kërkuesit mbetet në kuadrin e dëmit pasuror, i cili është kurdoherë i rikuperueshem dhe i zëvendësueshem dhe nuk rrezikon apo pamundëson ekzistencën e vetë të

drejtës. Kjo gjykatë çmon se kërkimi për marrjen e masës së sigurimit të padisë nuk mund të mbështetet vetëm në argumente hipotetike. Në kuadrin e një kërkese të tillë, gjykata duhet të marrë një vendim me efekt të përkohshëm, nëse për këtë është urgjentisht e nevojshme në mënyrë që të parandalohen dëme të rënda, apo për çfarëdo arsye tjetër që është thelbësore në funksion të së mirës publike. Gjykatës i nevojitet të vendosë në një balancë pasojat që mund të vijnë nëse masa e kërkuar nuk merret prej saj dhe në përfundim do të rezultojë se ankimi është i suksesshëm, përkundrajt dëmeve që do të ndodhin në rastin kur masa e përkohshme do të merrej, por në përfundim të gjykimit kërkesa do të rrëzohej. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se shkaqet e ngritura në ankimin e veçantë të personit të tretë IKMT dhe Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Vlorë janë të mbështetura në ligj dhe në prova, përse i përket pabazueshmërisë në prova shkresore të ekzistencës së tre kushteve themelore të parashikuara në nenin 29 të ligjit nr. 49/2012, që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë duhet të merrte në konsideratë përpara se të vendoste në favor të kërkesës për marrjen e një mase sigurimi padie. Gjykata Administrative e Apelit përfundimisht çmon se mbajtja e procesverbalit nr. 02, datë 07.03.2021, seria nr. 0001832 “Për konstatimin e kundërvajtjes”, dhe njoftimi i tij palës kërkuese, nuk është i mjaftueshëm si provë që të provojë se asaj do ti vijë një dëm: i) i rëndë; ii) i pakthyeshëm iii) i atëçastshëm, nga veprimet e personit të tretë IKMT. Vetëm pas vlerësimit të drejtë duke u mbështetur në prova shkresore të këtyre kriterëve gjykata mund të vendosë si masë sigurimi pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ që kundërshtohet dhe, në rast se një masë e tillë nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme, gjykata mund të vendosë edhe masa të tjera të përshtatshme krahas asaj të pezullimit. Si rregull, masë sigurimi që mund të merret në gjykimin e një mosmarrëveshjeve administrative është ajo e pezullimit të zbatimit të veprimit administrativ. Përgjithësisht, ligji nr. 49/2012 ka lejuar marrjen e masave të tjera, kur, sipas rrethanave të çështjes, pezullimi i aktit administrativ në zbatimin e tij nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme në lidhje me sigurimin e efektivitetit dhe dobishmërisë së procesit gjyqësor që do të realizohet mes palëve. Kërkesa për sigurimin e padisë nuk përbën gjykim themeli. Është pikërisht gjykimin e themelit ai i cili do të mundësojë paditësit të rivendosë në vend të drejtën e tij të pretenduar si të shkelur nga ana e palës së paditur.

14. Kundër vendimit nr. 42, datë 27.04.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs me datë 18.05.2023, kërkuesi shoqëria “Dhërmiu-001” shpk. dhe Kristaq Beli, të cilët kanë kërkuar prishjen e vendimit nr. 42, datë 27.04.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 210, datë 14.09.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Në rekurs kërkuesit kanë pretenduar ndër të tjera se:

- Vlerësim i Gjykatës Administrative të Apelit është i cekët, i pambështetur në provat e paraqitura në gjykim dhe kryer në interpretim të gabuar të ligjit. Nenet 28 dhe 29 të ligjit nr. 49/2012 parashikojnë marrjen e masës së sigurimit të padisë në rast të ekzistencës së një dyshimi të arsyeshëm për mundësinë e ardhjes së dëmit dhe nuk shprehen për detyrim për të provuar ardhjen e dëmit, siç shprehet gjykata e apelit. Madje procesi i të provuarit të ardhjes së dëmit e bën të pazbatueshëm institutin e marrjes së masës së sigurimit të padisë, pasi dëmi i ardhur dhe provuar nuk mund të parandalohet më, pra shmanget qëllimi për të cilin ligjvënësi ka parashikuar masën e sigurimit të padisë, si mjet për eliminimin e mundësisë së ardhjes së dëmit dhe mbajtjen e gjendjes “së ngrirë” deri në gjykimin e themelit të mosmarrëveshjes.
- Është për t'u theksuar se vendimi nr. 42, datë 27.04.2023 i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në dhomë këshillimi, ndërkohë që ngre pretendime provueshmërie të

mundësisë së ardhjes së një dëmi të rëndë e të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm. Ndërkohë, vetë Gjykata Administrative e Apelit, megjithëse e mbështet vendimin në vlerësime për mungesën e provueshmërisë së dyshimit për mundësinë e ardhjes së demit të rëndë e të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm dhe megjithatë parashikimin e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 ka vlerësuar të zhvillojë gjykimin në dhomë këshillimi.

- Nëse kishte rezerva lidhur me verifikimin e dyshimit për mundësinë e ardhjes së demit, gjykata do të duhet të kishte zhvilluar gjykimin në seancë gjyqësore. Në këtë mënyrë, do të konstatonte se, pa komunikuar vendim për prishjen e objektit prej IKMT-së janë rrëzuar mure dhe janë shpuar gjithë kolonat e katit nëntokë të objektit të ndërtuar me lejen e ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të Këshillit të Rregullimit të Territorit, Bashkia Himarë, me qëllim vendosjen e eksplozivit dhe shembjen e objektit. Njëkohësisht do të mund të verifikonte se me ngritjen e padisë për konstatimin e paligjshmërisë së veprimeve të IKMT-së është kërkuar edhe shpërblimi i demit të shkaktuar në objekt nga veprimet e tyre. Tregues më të qartë se ky fakt për mundësinë e ardhjes së demit gjykata e apelit s'do të mund të gjente.
- Nga ana tjetër, gjykata e apelit ka kryer një vlerësim të gabuar referuar ekzistencës së dyshimit për mundësinë e ardhjes së demit. Gjykata e përqendron gjithë arsyetimin në vlerën provuese të procesverbalit nr. 02, datë 07.09.2021, seria nr. 0001832 "Për konstatimin e kundërvajtjes" i IKMT-së lidhur me mundësinë e ardhjes së demit, duke mos marrë në vlerësim asnjë nga provat e tjera të paraqitura dhe rrethanat e relatuar nga pala kërkuese.
- Për ekzistencën e dyshimit për mundësinë e ardhjes së demit të kërkuar nga ligji shërben më së miri edhe procesverbali nr. 02, datë 07.03.2021, seria nr. 0001832 "Për konstatimin e kundërvajtjes" IKMT-së. Kjo sepse ky proces verbal pasqyron si shkelje punime ndërtimore të kryera me leje ndërtimi. Një vendim i IKMT-së, i nxjerrë në bazë të konstatimeve të këtij procesverbal është menjëherë i ekzekutueshëm, pasi ekzekutimi i tij nuk kushtëzohet nga asnjë afat apo procedure ankimore. I vetmi mjet mbrojtjeje ndaj shkaktimit të demit, si pasojë e ekzekutimit të një vendimi të nxjerrë në bazë të konstatimeve të gabuara apo qëllimisht të gabuara të IKMT-së apo nga kryerja e veprimeve arbitrare të IKMT-së pa komunikuar as vendim për prishjen e objektit, është marrja e masës së sigurimit të padisë.
- Gjykata e apelit duhet të merrte në vlerësim praninë e inspektorëve të IKMT-së në objekt në datën 09.09.2021, me qëllim përcaktimin e mënyrës së vendosjes së eksploziveve, pa komunikuar akoma as procesverbal të konstatimit të kundërvajtjes dhe as vendim për prishjen e objektit. Gjykata e apelit duhet të merrte në vlerësim edhe paraqitjen e IKMT-së me mjete të rënda në objektin e kërkuesve, me qëllim prishjen e tij dhe aq më tepër nisjen e veprimeve për shembjen e objektit, të pasqyruar në fotot e paraqitura në gjykim.
- Gjykata e apelit duhet të merrte në vlerësim gjithashtu qëndrimin e IKMT-së, e cila nuk i ka dërguar asnjë informacion gjykatës lidhur me vlerësimet dhe veprimet e saj.
- Gjykata e apelit duhet të merrte në vlerësim edhe faktin se në portale dhe televizione të ndryshme, qysh në gusht të vitit 2021 pra përpara kryerjes së çdo procedure verifikimi, është paralajmëruar prishja e objektit, duke u konsideruar i jashtë ligjshëm, pavarësisht ekzistencës së lejes së ndërtimit dhe deklarimit të shtesave për legalizim. Është e qartë se ky informacion nuk ka pasur burim kërkuesit por organin e ngarkuar me verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, pra IKMT-në.

- Nga sa më sipër, rezulton se gjykata e apelit ka kryer një vlerësim selektiv të provave dhe rrethanave të çështjes, duke mos pasqyruar aspak në vendim dhe duke mos marrë në shqyrtim shumicën prej tyre.
- Vendimi i apelit i bën praktikisht të pazbatueshme nenet 28 dhe 29 të ligjit nr. 49/2012, pasi po erdhi dëmi nuk ka më vend për marrjen e masës së sigurimit të padisë, ndërkohë që praninë e IKMT-së me mjete të renda ne objekt dhe veprimet e prishjes të ndërmarra në fakt gjykata nuk i konsideron se janë të mjaftueshme për ekzistencën e dyshimit për shkaktimin e dëmit. Praktikisht gjykata kërkon shprehje të qëllimit për prishjen e objektit nga IKMT, ndërkohë që provohet se ky organ nuk komunikon vendim për prishjen e objektit, ndërmerr në fakt veprime për prishjen dhe nuk i jep asnjë sqarim gjykatës lidhur me veprimet e ndërmarra prej saj për prishjen e objektit.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

15. Paraprakisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) e vlerëson të arsyeshme të sqarojë faktin se, rekursi është regjistruar pranë Gjykatës së Lartë në datën 02.07.2021 dhe shqyrtimi i tij në këtë moment bazohet në vetë natyrën dhe llojin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, si dhe në përcaktimet e neneve 202, 470 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (në vijim KPC). Kolegji vlerëson se ekzistojnë shkaqe ligjore për shqyrtimin me përparësi të një kategorie të caktuar çështjesh, të tilla si, rekursi e veçanta mbi vendimet e ndërmjetme për sigurimin e padisë, vendimet e ndërmjetme mbi diponimin e gjykatave për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, parashtrirat e gjykatave për kompetencë, me qëllim mbarëvajtjen e çështjeve gjyqësore, eficiencës, por edhe mosbllokimit të vijimit të shqyrtimit të tyre nga gjykata e niveleve më të ulëta, si dhe faktin që relatorja e çështjes po gjykon çështje të vitit 2023.

16. Kolegji sjell në vëmendje se në çështje të kësaj natyre, në referim edhe të jurisprudencës gjyqësore të konsoliduar të zhvilluar nga Kolegji Civil dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, si para edhe pas ndryshimeve ligjore të vitit 2021, duke pasur parasysh natyrën e posaçme të gjykimeve dhe afatet e shpejta me të cilën duhet të operojë ky autoritet, pa cenuar standardet e procesit të rregullt ligjor, zbatohet një rit i posaçëm i gjykimit rishikues, si për sa i përket aspektit procedural, nëpërmjet gjykimit të ankimeve e rekurseve të veçanta në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, ashtu edhe në disponimin e zgjidhjes në themel të çështjes. (*Shih vendimet nr. 1094, 1095, 1096, 1097 datë 08.07.2021 të Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë, vendimet nr. 704 datë 23.09.2020, nr. 725 datë 26.11.2020, nr. 728 datë 26.11.2020 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

17. Kolegji konstaton se rekursi i paraqitur nga pala paditëse brenda afatit ligjor i është komunikuar palës së paditur, e cila nuk rezulton të ketë përfituar nga e drejta që i njeh ligji për të paraqitur kundërrekurs, ashtu si edhe çdo kërkesë tjetër procedurale.

18. Kolegji vlerëson se në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi në tërësi i akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore, referuar objektit dhe shkakut të kërkesës për marrjen e masës së pezullimit, parashtrimeve të paraqitura nga palët gjatë seancave në gjykatat e niveleve më të ulëta, si dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore, rekursi përmban shkaqe ligjore, të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

19. Kolegji vlerëson se Kodi i Procedurës Civile dhe ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ" u kanë ofruar palëve ndërgjyqëse mjete të posaçme që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e

sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të KPC apo nenit 28 e vijues të ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të KPC apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas neneve 449, 469 dhe 479 të KPC. Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor, nga i cili ato varen; konkretisht padisë dhe ankimeve përkatëse në çdo shkallë gjykimi, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 13 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

20. Sigurimi i padisë, si institut procedural është parashikuar nga legjislatori për shmangien e rrezikut të ekzekutimit të vendimit dhe bëhet përpara se të jetë vërtetuar qëllimi i ligjit që garanton një të mirë të caktuar, apo përpara se të bëhet i mundur realizimi i të drejtës nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm.

21. Në referencë dhe në interpretim të dispozitave të neneve 28, 29, 30 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, i ndryshuar, në mënyrë që gjykata të vendosë për marrjen e një masë sigurimi padie, duhet të analizojë ekzistencën e tre kushteve themelore:

- a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin;
- b) nuk cenohet rëndë interesi publik;
- c) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t’i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

22. Në referim të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës së Lartë qëllimi i marrjes së masës për sigurimin e padisë referuar si legjislacionit shqiptar, por dhe legjislacionit ndërkombëtar është jo vetëm sigurimi i së drejtës, e cila përbën dhe tërësinë e kërtimeve që do të parashtrijë paditësi në padinë e tij, por në të njëjtën kohë dhe ajo që është më e rëndësishmja, është që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor, i cili do të realizohet mes palëve në të ardhmen, në mënyrë që kjo e drejtë të cilën paditësi kërkon të realizojë dhe të njohë nëpërmjet një procesi gjyqësor, të mos jetë e kërcënuar nga një dëm i menjëhershëm dhe i riparueshëm, dhe që vendimi përfundimtar të mos mbetet i paekzekutueshëm.

23. Sigurimi i padisë si institut juridik procedural nënkupton një vlerësim paraprak dhe sipërfaqësor të fakteve të çështjes nga gjykata, e cila nëse arrin në përfundimin se, ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit të themelit do të shkaktojë një dëm të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për të drejtat e paditësit (*kërkuesit*) dhe , se nuk cenohet rëndë interesi publik, atëherë lejon marrjen e saj.

24. Kolegji sjell në vëmendje se gjykimi për marrjen e masës për sigurimin e padisë është një proces i shpejtë, ku gjykata nuk shqyrton dhe vlerëson të gjitha provat në mënyrë të hollësishme për të parë nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e kërkuesit, nëse qëndron apo jo e drejta. Në gjykime të këtij lloji, gjykata vetëm heton nëse plotësohen këto kushte: “(a) *ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje në procesin e gjykimit të padisë, dhe (b) ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë.*” E kundërta ndodh në gjykimin e themelit të padisë gjatë të cilës gjykata, duke respektuar të gjitha normat procedurale shqyrton në themel nëse ekziston apo jo e drejta e pretenduar nga paditësi, nëse kërkimet e tij janë të mbështetura apo jo në prova dhe në ligj. (*Shih vendim nr. 22, datë 19.01.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*)

25. Kolegji thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në shkresa, për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin dhe mungesa e cenimit të interesit publik janë kushte kumulative, të cilat përlligjin nevojën për

marrjen e masës së sigurimit të padisë. Dhënia e garancisë nuk është një kusht i domosdoshëm në caktimin e masës së sigurimit të padisë, por një kusht alternativ, i nevojshëm vetëm nëse do të vlerësohej nga gjykata si i përshtatshëm për rrethanat e rastit, që do të aplikohet kurdoherë së bashku me dy kriteret e parashikuara në shkronjën a) dhe b)).

26. Në rastin objekt gjykimi, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka interpretuar drejtë dispozitat e ligjit procedural, në lidhje kushtet dhe kriteret për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Konstatohet se prej saj nuk është analizuar dhe argumentuar në mënyrë të drejtë një nga kushtet e domosdoshme që kërkohen për marrjen e masës së sigurimit të padisë, që është ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshem dhe të atëçastshëm për paditësin. Gjykata ka arsyetuar se kërkuesi duhet të paraqesë prova se nga veprimet e organit administrativ vjen një dëm i atëçastshëm tek paditësi, dëmi është i menjëhershëm dhe i riparueshem nëse pala paditëse do të rezultonte në përfundim të gjykimit të themelit gjyqfituese.

27. Referuar mosmarrëveshjes objekt gjykimi, lidhur me kushtet e parashikuara nga neni 29 shkronja a) të ligjit nr. 49/2012, Kolegji çmon se mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë, të atëçastshëm dhe gati të pakthyeshem për interesat që mbron pala paditëse është evidente, pasi materializimi në akte, i procesverbaleve të kontrollit do të sjellë automatikisht prishjen e objektit të ndërtuar nga pala paditëse. Kolegji duke marrë në vlerësim natyrën mikse të objektit, ku nga provat e administruara dhe vlerësuara nga gjykata e faktit objekt gjykimi rezulton që një pjesë e tij është me leje dhe një pjesë pa leje, duke marrë në vlerësim indiciet e parashtruara dhe provat e paraqitura nga pala paditëse si, procesverbal konstatimi, planimetritë e objektit, lejet e ndërtimit, foto të ndërtimit ku dallon qartazi punonjës të IKMT në godinë, si dhe çështjen e bërë mediatike tashmë në lidhje me prishjen e objektit (sipas akteve të depozituara në dosjen gjyqësore), vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit për rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë është marrë në aplikim të gabuar të ligjit material dhe procedural.

28. Në lidhje me konkluzionet e arritura nga Gjykata Administrative e Apelit, nga ku ndër të tjera citohet se “*përfundimisht çmon se mbajta e procesverbalit nr. 02, datë 07.03.2021, seria nr. 0001832 “Për konstatimin e kundërvajtjes”, dhe njoftimi i tij palës kërkuese, nuk është i mjaftueshem si provë që të provojë se asaj do ti vijë një dëm: i) i rëndë; ii) i pakthyeshem iii) i atëçastshëm, nga veprimet e personit të tretë IKMT*”, Kolegji i vlerëson të gabuara këto konkluzione. Në rastin objekt gjykimi është i provuar fakti se pala paditëse çenohet efektivisht nga prishja e objektit, veprime këto të konkluduara nga shkresa nr. 3545/1 prot., datë 08.09.2021 (njoftimi i procesverbalit të konstatimit) pas datës 11.09.2021 të lëshuar nga IKMT.

29. Po kështu, Kolegji në këtë rast mban parasysh dhe kriteret e parashikuara nga neni 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 nga ku IKMT brenda 10 ditëve nga marrja e kopjes së procesverbalit ose e njoftimit për rezultatin e kontrollit IKMT nxjerr vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, fakte këto të ndërmara de facto nga punonjësit e IKMT (*kanë veprime në funksion të prishjes së objektit pa u njoftuar kërkuesve ndonjë vendim përfundimtar të IKMT-së për prishjen e objektit*).

30. Po kështu, Kolegji ka në vëmendje dhe faktin që pothuajse i gjithë objekti është i pajisur me leje ndërtimi, përveç “*shtesë kati nëntokë, shtesë anësore kati 3-të, shtesë kati 4-të dhe shtesë kati 5-të pa leje ndërtimi ...*” evidentuar kjo sipas proces-verbalit të konstatimit. Ndërkohë, Objekti është i pajisur me leje ndërtimi me vendimi KRRT nr. 62, datë 16.12.2010 dhe miratimin e shtyrjes së lejes nr. 121, datë 13.12.2019, të KRRT Bashkia Himarë deri në datën 13.12.2021, cka do të thotë se për ekzekutimin de jure të këtij akti (proces-verbal konstatimit), paditësi i vjen dëm i rëndë, të pakthyeshem dhe të atëçastshëm pasi për gjendjen e faktit objekti është i miksuar

objekti nën tokë është pa leje ndërtimi, cka do të thotë se për ekzekutimin e proces-verbalin në fjalë duhet të priset i gjithë objekti.

31. Kolegji vlerëson se, provohet fakti që ka të bëjë me situatën e emergjencës, që do të thotë se pavarësisht se kërkuesi vërteton mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë nga veprimet e palës së paditur apo se e drejta e cënuar nuk ka mundësi objektive të restituohet për shkak të rrethanave që mund të ngjajnë deri në përfundim të gjykimit, dëmi i rëndë i prezumuar duhet të ketë filluar ose së paku ardhja e tij është e pashmangshme dhe se nuk mund të presë përfundimin e gjykimit.

32. Sa sipër, Kolegji vlerëson dhe evidenton faktin se nuk cënohet interesi publik, i cili duhet kuptuar si raport mes mirëqenies individuale dhe asaj komunitare. Si rregull masa e sigurimit të padisë përbën kufizim të të drejtave të palës së paditur apo pezullim të ligjshmërisë së prezumuar të një akti administrativ, si e tillë në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë duhet të jetë proporcionale dhe e justifikuar ligjërisht për mbrojtjen e të drejtave të palës tjetër ose interesit publik (shih vendimin nr. 763, datë 02.06.2021 dhe atë nr. 801, datë 03.06.2021 të Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë).

33. Nga aktet e dosjes ka rezultuar se vetë organet ligjzbatuese kanë pajisur paditësin me leje ndërtimi nga ku dhe i kanë shtyrë afatin e kësaj leje ndërtimi deri në datën 13.12.2021.

34. Gjithashtu nga aktet në dosje nuk na rezulton që organet ligjzbatuese në vendin objekt shqyrtimi kanë të paraqitur ndonjë plan të zhvillimit strategjik që do ta bënte të thyeshëm interesin publik. Në lidhje me paligjshmërinë pjesore të paditësit sipas proces-verbalit të konstatimit të IMT, Kolegji mban në vëmendje vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 10, datë 24.03.2004, i cili në lidhje me çmimin e provave në një shqyrtim të tillë mban qëndrimin se: *"Gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel..."* Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se, pala kërkuese nëpërmjet këtij kërkimi për marrjen e masës së sigurimit të padisë, nuk po kërkon të arrijë atë që ka në thelb të kërkimit të saj për zgjidhjen e çështjes në themel, por gjithë kërkimi i tij kushtëzohet nga interpretimi i dispozitave nenet 28, 29, 30 të ligjit 49/2012 i ndryshuar.

35. Kolegji çmon se kërkimi për marrjen e masës së sigurimit të padisë nuk mund të mbështetet vetëm në argumente hipotetike, por nga ana tjetër, gjykata duhet të mbajë në konsideratë se vlerësimi mbi sigurimin e padisë bazohet në ekzistencën e dyshimi të arsyeshëm, pra mbi baza probabiliteti. Në shqyrtimin e kësaj kërkese, Kolegji thekson se nuk është e nevojshme që gjykata të jetë e bindur tej çdo dyshimi të arsyeshëm ose e sigurt për ekzistencën apo mundësinë e ardhjes së dëmit të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm. Dyshimi i ardhjes së pasojës nënkupton që kriteri ligjor i justifikimit të masës së sigurimit nuk kërkon me patjetër ardhjen tashmë të një pasoje konkrete. Në kuadrin e një kërkese të tillë, gjykata duhet të marr një vendim me efekt të përkohshëm, nëse për këtë është urgjentisht e nevojshme në mënyrë që të parandalohen dëme të rënda, apo për çfarëdo arsye tjetër që është thelbësore në funksion të së mirës publike. Gjykatës i nevojitet të vendos në një balancë pasojat që mund të vijnë nëse masa e kërkuar nuk merret prej saj dhe në përfundim do të rezultojë se ankimi është i suksesshëm, përkundrajt dëmeve që do të ndodhin në rastin kur masa e përkohshme do të merrej, por në përfundim të gjykimit kërkesa do të rrezohej. Kolegji vlerëson se një vendim gjyqësor për marrjen e masës së përkohshme jepet në atë rast kur, pa dhënien e një vendimi të tillë, ekziston një rrezik i drejtpërdrejtë që i tërë procesi shqyrtimit të çështjes, do të bëhej i pakuptimtë ose, për më tepër, absurd. Kolegji arrin në një përfundim të tillë duke mbajtur në konsideratë vetë natyrën e përkohshme dhe instrumentale të masës së sigurimit të padisë.

36. Referuar sa më sipër, nuk rezulton që Gjykata Administrative e Apelit të ketë arsyetuar mbi (mos)ekzistencën e kushteve që kërkohen sipas nenit 29 të ligjit 49/2012. Kolegji vlerëson se gjykata kishte detyrimin ligjor të argumentonte duke peshuar dëmin e mundshëm që mund të shkaktohet, si në rastin e marrjes së masës së sigurimit të padisë, ashtu edhe në rastin e rrezimit të kërkesës. I përket gjykatës së faktit të vendos të mos zbatojë një masë sigurimi padie nëse bindet për panevojshmërinë e saj, apo nëse dëmi që mund të shkaktohet nga vendosja e masës e tejkalon dëmin potencial të mundshëm që rrezikon të ndodhë në rastin kur veprimet e organit publik do të vazhdojnë të shkaktojnë efekte deri në dhënien e një vendimi përfundimtar mbi themelin e gjykimit. Gjykata ka detyrimin që të peshojë mirë avantazhet dhe disavantazhet që do të vijnë si pasojë e dhënies së vendimit në dritën e një përfundimi të mundshëm të çështjes themelore. Mungesa e një arsytimi të tillë e bën të cenueshëm vendimin e gjykatave.

37. Për sa më sipër Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të priset duke disponuar me lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë Vlorë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 63(1)(b) të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar),

VENDOSI:

Prishjen e vendimit nr. 42, datë 27.04.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 210, datë 14.09.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë Vlorë.

Tiranë, më 27.07.2023

ANËTAR

Asim VOKSHI
(Kundër)

ANËTARE

Arbena AHMETI

KRYESUESE

Enkelejda METALIAJ (SOFTA)

VËRTETOHET NJËSIA ME ORIGINALIN

KRYESEKRETARE
TEUTA NUREDDIN



MENDIM PAKICE

(i gjyqtarit Asim VOKSHI)

1. Në çështjen administrative me nr. 35005-00276-00-2023 regj.them, që i përket:

KËRKUES: 1) Shoqëria "Dhërmu-001" shpk. 2) Kristaq Beli.

PALË E TRETË: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit Tiranë

Me pjesëmarrjen e: Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Vlorë.

OBJEKTI: Marrja e masës së sigurimit të padisë, pezullimi i gjithë veprimeve të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Tiranë për prishjen e objektit të palës kërkuese, të ndërtuar sipas lejes së ndërtimit nr. 62, datë 16.12.2010 të Këshillit të Rregullimit të Territorit, Bashkia Himarë dhe zgjatjes së afatit të saj me vendimin nr. 121, datë 13.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë Himarë.

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 154, të Kodit të Procedurës Civile, ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit". Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

2. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi shumica me vendimin e datës 27.07.2023 vendosi:

"Prishjen e vendimit nr. 42, datë 27.04.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 210, datë 14.09.2021 të Gjykatës Administrative e Shkallës të Parë Vlorë."

3. Duke qenë kundër vendimmarrjes së mësipërme të shumicës së trupit gjykues, çmoj të parashtroj përmbledhtazi në vijim arsyet në të cilat mbështes mendimin tim të mbetur në pakicë.

4. Pakica vlerëson se është antikushtetuese dhe jo ligjore që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë të luajë rolin që i takon gjykatave të faktit, sa i përket hetimit gjyqësor të çështjes dhe vlerësimit të provave. Kjo është afirmuar në mënyrë të vazhdueshme nga jurisprudenca konstante e Gjykatës Kushtetuese. Kolegjet e Gjykatës Administrative të Apelit e kanë analizuar dhe vlerësuar drejtë gjendjen faktike (mbi ato prova që gjendeshin në dosje) e mbi këtë bazë kanë vlerësuar se nuk ekzistonin arsye ligjore për sigurimin e padisë para ngritjes së saj. Ata me të drejtë kanë arritur në përfundimin se: *"[...] mbajtja e procesverbalit nr. 02, datë 07.03.2021, seria nr. 0001832 "Për konstatimin e kundërvajtjes", dhe njoftimi i tij palës kërkuese, nuk është i mjaftueshëm si provë që të provojë se asaj do ti vijë një dëm: i) i rëndë; ii) i pakthyeshëm iii) i atëçastshëm, nga veprimet e personit të tretë IKMT. [...]"* Siç me të drejtë ka arsyetuar në ankimin e saj IKMT, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, gjykata e shkallës së parë ka treguar njëanshmëri në gjykim.

5. Ky vendim i shumicës së Kolegjit, i marrë në fund të muajit Korrik 2023, është në mendimin tim të pakicës jo vetëm krejtësisht i gabuar (*ashtu siç është edhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, i rretëzuar nga Kolegji*), por që cenon rëndë parimet bazë të gjyimit administrativ dhe mosparagjykimin të çështjeve nga gjyqtarët, si dhe respektimit të rolit të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji. Dukshëm rezulton se shumica lë në fuqi disponimin e gjykatës administrative të Shkallës së

Parë Vlorë, e cila pezullon veprimet e prishjes, pa pasur të tilla, d.m.th pa pas nxjerrë IKMT ndonjë akt për prishje tërësore apo pjesore të objektit të realizuar në shkelje të lejes së ndërtimit. Këtë e hamendëson shumica se do ndodhë, duke u shprehur se pas procesverbaleve të kontrollit do të vijë “automatikisht prishja e objektit të ndërtuar nga pala paditëse”. Në këtë rast, gjykata administrative e Shkallës së Parë Vlorë dhe shumica e Kolegjit Administrativ paragjykojnë haptazi vendimmarrjen e ardhshme të organit administrativ dhe ndalojnë paraprakisht mundësinë e vlerësimit dhe disponimit nga ky organ të opsioneve të ndryshme në lidhje me paligjshmërinë e konstatuar. Kjo do të thotë, që gjykatat “i lidhin duart” administratës dhe e ndalojnë atë paraprakisht të ushtrojë kompetencat e veta që i njeh ligji. Në këtë mënyrë gjykatat nuk gjykojnë, por paragjykojnë, çka bie ndesh me parimet më elementare të procesit të drejtë gjyqësor. Pse e bëjnë ato këtë, nuk e kam aspak të qartë, bazuar mbi kriteret që parashikon ligji nr.49/2012.

6. Arsyetimi i shumicës se: *“Kolegji duke marrë në vlerësim natyrën mikse të objektit, ku nga provat e administruara dhe vlerësuara nga gjykata e faktit objekt gjykimi rezulton që një pjesë e tij është me lejë dhe një pjesë pa leje, duke marrë në vlerësim indiciet e parashtruara dhe provat e paraqitura nga pala paditëse si, procesverbal konstatimi planimetritë e objektit, lejet e ndërtimit, foto të ndërtimit ku dallon qartazi punonjës të IKMT në godinë , si dhe çështjen e bërë mediatike tashmë në lidhje me prishjen e objektit (sipas akteve të depozituara në dosjen gjyqësore) vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit për rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë është marrë në aplikim të gabuar të ligjit material dhe procedural”, i përshtatet gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit dhe jo në Gjykatën e Lartë. Shumica në këtë rast merret me analizën e provueshmërisë së rrezikut të ardhjes së një dëmi të rëndë, bazuar mbi të dhëna mediatike, që nuk dihet se çu vlerë kanë, e në ç’rrethana janë publikuar. Nëse kishte dyshime për saktësinë e fakteve, Kolegji mund ta kthente çështjen për rigjykim, e jo të analizonte vetë provat në mënyrë të ndryshme nga sa ka bërë gjykata më e ulët. Shumica rrëzon vendimmarrjen e gjykatës Administrative të Apelit duke bërë gjykim në fakt, e duke u shprehur se i gjen të gabuara konkluzionet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe se “në rastin objekt gjykimi është i provuar fakti se pala paditëse cenohet [...]”. Ky konstatim i shumicës është prova më e mirë e pabazueshmërisë në ligj të vendimmarrjes së saj, pasi Gjykata e Lartë nuk ka për detyrë dhe kompetencë të vlerësojë në mënyrë të ndryshme provueshmërinë apo jo të fakteve të caktuara.*

7. Shumica flet për “ekzekutim de jure” të procesverbalit të konstatimit të shkeljes administrative, ndërkohë që nuk kuptohet çu është ky koncept i ri juridik, pasi ekzekutimi është gjendje fakti por edhe ligjore njëkohësisht. Çfarë do të thotë ekzekutim de jure i një akti konstatimi? Ekzekutimi a lidhet me vendimmarrjen e IKMT për prishje dhe a duhet që kjo e fundit ta marrë këtë vendim njëherë, para se të kryhen veprimet e prishjes? Mendoj se po. Nga ana tjetër, Gjykata Administrative nuk mund të marrë vendim për pezullim të një vendimi që nuk dihet nëse do merret apo jo nga IKMT dhe që nëse merret, ka procedurën e vet të ankimit gjyqësor. Shumica justifikon vendimmarrjen e saj duke analizuar fakte të patrajtuara më parë, në lidhje me miksimin e objektit në pjesën me leje dhe atë pa leje, kur një gjë të tillë nuk e ka konstatuar as vetë gjykata administrative e shkallës së parë e cila ka dhënë këtë masë sigurimi ekstremisht të paligjshme. Vetë ajo gjykatë ka arsyetuar se: *“Ndërsa, sa i përket objekteve informale të cilat janë objekt deklarimi të “Kërkesës për legalizim të ndërtimit pa leje” nr. 9342, datë 20.05.2021 dhe të “Kërkesës për legalizim të ndërtimit pa leje” nr. 19222, datë 09.09.2021 nuk konstatohet nëse ato janë lidhura si shtesë me objektin e ligjshëm të sipërcituar, sepse në këto deklarime nuk është bërë*

shënimi "Objekt me shkelje të lejes së ndërtimit". Kësisoj Gjykata e Lartë del në konkluzione novatore fakti, e duke e bërë këtë, shkel kompetencën e saj funksionale.

8. Shumica arsyeton se nuk cenohet interesi publik në këtë rast, porse a ka interes më të lartë publik sesa ushtrimi i kompetencave nga organet administrative sipas ligjit. Duke paragjykuar çështjen e duke i pamundësuar paraprakisht organin administrativ që të marrë një vendim (qoftë ai edhe për prishje të plotë apo të pjesshme të objektit të paligjshëm), e më pas ky vendim të goditet gjyqësisht, shumica e Kolegjit zhbën kompetencat ligjore të IKMT dhe i pamundëson asaj *a priori* zbatimin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimeve. Në këtë rast mendoj se interesi publik për shtet ligjor, i cili prevalon mbi çdo interes tjetër, është cenuar tejet rëndë.

9. Shumica i jep autoritet vendimmarrjes së saj duke cituar vendimin unifikues nr.10, datë: 24.03.2004, i cili nuk gjen zbatim për paditë administrative, por vetëm për gjykimet civile. Këtë e thotë vetë ky vendim unifikues në pjesën fundore të tij, kur shprehej se: "Në praktikën e gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve vërehet shpesh që ato konsiderojnë si masë sigurimi të padisë edhe pezullimin e zbatimit të një akti administrativ të kundërshtuar në gjykatë, duke iu referuar, krahas nenit 329 të K.Pr.Civile, edhe nenit 202 e 206/b të këtij Kodi. Këto probleme nuk janë objekt shqyrtimi në këtë çështje. Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë të mendimit se kërkesa për kundërshtimin në gjykatë të një akti administrativ nuk ka tiparet e një padie civile të mirëfilltë, prandaj edhe pezullimi i zbatimit të aktit administrativ nga ana e gjykatës, kur e lejon ligji, nuk duhet të konsiderohet si një masë e përkoheshme për sigurimin e padisë në kuptim të nenit 206, pika "b", të K.Pr.Civile. Prandaj, referenca në këtë rast edhe në nenin 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile nuk është e saktë."

10. Bazuar në sa më sipër, jam i detyruar të mbaj një qëndrim pakice në këtë çështje, pasi ajo nuk ngre asnjë çështje ligji të denjë për Gjykatën e Lartë, por ngërthen çështje dhe vlerësime fakti (provueshmërie), të cilat dalin jashtë kompetencës tonë. Tejkalimi i kompetencës në këtë rast, bllokoi mundësinë e IKMT që të vlerësojë nëse dhe si (formën) do e zbatojë ligjin në këtë rast, ku siç pranohet edhe nga shumica "[...] pothuajse i gjithë objekti është i pajisur me leje ndërtimi, përveç "shtesë kati nëntokë, shtesë anësore kati 3-të, shtesë kati 4-të dhe shtesë kati 5-të pa leje ndërtimi [...]" evidentuar kjo sipas proces-verbalit të konstatimit [...]" Fjala përveç në këtë rast, nxjerr në pah volume gjigante ndërtimore që e bëjnë të pashpjegueshme ligjërisht se si mund të bllokohet IKMT-ja nga gjykatat që të vlerësojë nëse duhet të prishen apo jo. Ndaj, nuk bashkohem me vendimmarrjen dhe arsyet e shumicës në marrjen e këtij vendimi dhe mendoj se jo vetëm është tejkaluari roli i Gjykatës së Lartë, por mbi të gjitha është dëmtuar rëndë parimi i ligjshmërisë dhe mos cenimit të rëndë të interesit publik, në kuptim të nenit 29 të ligjit nr.49/2012.

11. Në zbatim të nenit 307 paragrafi i dytë të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 35(3) të ligjit nr.98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" ky mendim pakice i bashkëlidhet vendimit të shumicës.

GJYQTAR

Asim VOKSHI

VËRTETOHET NJËSIA ME ORIGINALIN

KRYESEKRETAR
TEUTA NUREDDIN

